



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Tiranë, më 01.07.2022

THIRRJE E HAPUR

Bordi i Administrimit të UST, bazuar në Rregulloren e funksionimit të tij, hap thirrjen për “Sekretar Teknik të Bordit të Administrimit” sipas vendimit të marr nga ana e tij në mbledhjen e dates 30 qershor 2022..

Detyrat e Sekretarit teknik të Bordit të Administrimit sipas Rregullores së sipërcituar janë:

- Të administrojë dokumentacionin e mbledhjeve të Bordit, sipas akteve ligjore në fuqi.
- Ndjek dhe njofton strukturat e IAL për Vendimet e Bordit të Administrimit dhe kujdeset deri ne publikimin e tyre në faqen e internetit të IAL-së.
- Realizon çdo detyrë që i ngarkohet nga Kryetari i Bordit që lidhet me objektin dhe funksionet e veprimtarisë së Bordit.

Kriteret e aplikimit:

Aplikimi është i hapur për të gjithë aplikantët që vijnë nga stafi administrativ i UST-së.

Kandidati duhet të zotërojë diplomë Bachelor, Master DIND ose DND.

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin në sekretarine e UST-së deri në datën 8 korrik 2022 shprehjen e interesit për këtë pozicion dhe një CV sëbashku me diplomën apo certifikata kualifikimesh të tjera, të cilat do të ishin në përshtatshmëri me këtë pozicion.

Bordi i Administrimit do të mblidhet në datën 12 korrik 2022 për të vlerësuar kandidaturat.

Bordi i Administrimit